



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:019666

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05856782

KE.nr. 898/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit “Intercoop-Group” Sh.P.K., me nr. të biznesit 810415762 dhe seli në Pejë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Xhevat Balaj nga Prishtina, kundër të paditurës D.P.Z Auto Elektricist “ELMIA” me seli në Pejë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Besim Tafa nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 11.06.2024 në të cilin prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me datën 25.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Intercoop-Group” Sh.P.K., me të cilin ka kërkuar që të detyrohet i padituri D.P.Z Auto Elektricist “ELMIA” që në emër dëmit material për shkak të djegies së veturës me datë 30.07.2017, t’ia paguaj dëmin material dhe fitimin e humbur sipas lartësisë e cila do të caktohej me ekspert nga lëmia financiare, të gjitha këto me kamatë ligjore nga data e shkaktimit të dëmit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimi, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.
- II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

*1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi “Intercoop-Group” Sh.P.K. me seli në Pejë, me datë 10.02.2020 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike kundër të paditurës

D.P.Z Auto Elektricist “ELMIA” me seli në Pejë, me objekt kontesti kompensim i dëmit real dhe fitimit të humbur.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, sipas kompetencës lëndore është transferuar pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësi me datë 30.07.2020 ka dërguar automjetin Kombi-Bus Pezho, ngjyrë e bardhë, me tabela ... tek e paditura për ta rregulluar pasi që automjeti ka pasur problem me ndezje të motorit. Ka sqaruar se të nesërmen, shoferi i këtui paditësit ka shkuar për ta marrë automjetin e riparuar dhe pasi që e ka vozitur diku rreth 2km nga vendi i servisit të të paditurës, automjeti në fjalë është djegur në tërësi, pas të cilës ngjarje, shoferi i paditësit ka thirrur zjarrfikësit për ta ndihmuar në shuarjen e zjarrit. Ka theksuar se lidhur me dëmet që i janë shkaktuar në automjet, paditësi menjëherë e ka informuar përfaqësuesin e të paditurës si dhe policia është njoftuar me rastin. Ka sqaruar se me shënimin zyrtar të lëshuar nga Prokuroria Themelore në Pejë PPN.II.nr. 1093/19 të datës 05.12.2019 është konstatuar se dëmi i shkaktuar tek paditësi është bërë pa qëllim nga tani e paditura dhe paditësi është udhëzuar në kontest civil për kërkesë pasurore juridike.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor fillimisht ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesës së saj ndërsa në fjalën përfundimtare, ka theksuar se meqenëse nga ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve është vërtetuar se dëmi nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të të paditurës, atëherë ka kërkuar nga gjykata që me rastin e vendosjes sipas kësaj çështje kontestimore, të vendos që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës meqenëse paditësit i janë shkaktuar dëme të mëdha me djegien e automjetit i cili ka qenë objekt i këtij kontesti gjyqësor.

I padituri me përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se padia nuk përmban asnjë provë nga e cila dëshkohet përgjegjësia e të paditurës për shpërblimin e dëmit. Ka shtuar se marrë parasysh faktin se vetura e paditësit është djegur në momentin kur e njëjta ka qenë në posedim të paditësit, atëherë përgjegjësinë për të vërtetuar se vetura është dëmtuar nga veprimet e të paditurit i takojnë palës paditëse, por që nga provat e administruara, nuk mund të vërtetohet lidhja kauzale mes veprimeve të të paditurës dhe pasojës në automjetin e paditësit.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, i padituri ka vazhduar ta kundërshtoj padinë e paditësit, duke theksuar tutje se nga administrimi i ekspertizës së hartuar nga grupi i

ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, si dhe nga sqarimet e dhëna nga eksperti N.L. në seancën e datës 11.06.2014, në mënyrë të saktë dhe shkencore është konstatuar se deri tek djegia e automjetit të paditësit nuk ka ardhur si rezultat i intervenimit të të paditurit në ndërrimin e unazës rrëshqitëse të brushave dhe se grupi i ekspertëve ka eliminuar çdo dyshim apo dilemë që automjeti i paditësit të jetë djegur si rezultat i intervenimit të të paditurës. Andaj gjykatës i ka kërkuar që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

## *2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar*

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 11.06.2024 ka bërë administrimin e provave si në vijim: fatura nr. kuponi 005022 e datës 30.07.2019, shënimi zyrtar nga Prokuroria Themelore në Pejë PPP.II.nr.1093/19 i datës 05.12.2019; kartela e viktimës me nr. të rastit 2019-DA-1477; Ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me përbërje prej ekspert N.L., ekspert I.D. dhe ekspert Sh.L., e hartuar me date 03.02.2022.

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 29.07.2019, paditësi, ka dërguar automjetin pronë e tij e tipit Kombi-Bus Pezho, ngjyrë e bardhë, me tabela ... për riparim tek e paditura, ashtu që mjete i riparuar është tërhequr nga shoferi i paditësit në ditën e nesërme, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga fatura me nr. kuponi 005022 e datës 30.07.2019.

Po ashtu, nuk ishte kontestues fakti se ditën kur automjeti në fjalë është tërhequr nga paditësi më 30.07.2019, i njëjti, gjatë kohës sa ishte në vozitje e sipër nga shoferi i paditësit ishte përfshirë në flakë.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike e kërkesëpadiës, konkretisht a ka ardhur deri tek djegia e automjetit pronë e paditësit si pasojë e veprimeve neglizhente të të paditurës me rastin e riparimit të automjetit.

Nga provat tjera të administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga shënimi zyrtar PPP.II.nr.1093/19 i datës 05.12.2019 gjykata konstatoi faktin se Prokuroria Themelore në Pejë ka hartuar shënim në të cilin ka sqaruar se me datë 23.10.2029 ka pranuar raport të veçantë të përpiluar me datë 17.10.2019, në të cilin raport është sqaruar se me datë 30.07.2019, rreth orës 18:35, në polici është iniciuar rasti ‘dëmtim apo asgjësim i pronës’ raportim nga E.M., i cili ka deklaruar se ka dërguar automjetin për riparim në auto servis “Hilmija” dhe pas tërheqjes së automjetit, automjetin e ka kapluar flaka. Në bazë të këtij shënimi zyrtar, Prokuroria Themelore ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk ekzistojnë elementet e veprës penale në mungesë të elementit të dashjes, por që në rastin konkret kemi të bëjmë me një raport civilo-juridik.

Nga kartela e viktimës me nr. të rastit 2019-DA-1477 gjykata konstatoi se këtu paditësi, është pajisur me kartelë me datë 18.10.2019 në lidhje me rastin e paraqitur me nr. 2019-DA-1477.

Me qëllim të vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë, konkretisht faktit se si ka ardhur deri tek dëmtimi i automjetit pronë e paditësit, gjykata, sipas propozimit të palës paditëse, ka bërë marrjen e provës me ekspertizë nga grupi i ekspertëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me përbërje prej ekspert N.L., ekspert I.D. dhe ekspert Sh.L..

Grupi i ekspertëve, përmes ekspertizës së hartuar me datë 03.20.2022, kanë konstatuar se pas ekzaminimit gjithëpërfshirës të automjetit te djegur pronë e paditësit, nuk është arritur të konkludohet se djegia ka ardhur si pasojë e intervenimit të këtu të paditurit ne rregullimin e alternatorit respektivisht ndërrimin e unazës rrëshqitëse te brushave. Deri tek ky konstatim grupi i ekspertëve ka theksuar se ka ardhur për faktin se nuk është konstatuar se alternatori i ekzaminuar ka pasur pjesë të thyera që do ta vërtetonte simptomën e kersimes qe e ka dëgjuar shoferi, tutje se rregullatori i tensionit te alternatorit te automjetit te djegur nuk është zëvendësuar dhe tensionin që e ka prodhuar alternatori para riparimit ka qene i njëjtë me atë pas riparimit, se bateria e ekzaminuar nuk ka pasur gjurme te pëlçitjes dhe stubat/celulat brenda baterisë kanë qenë të pa dëmtuara edhe pas djegies se automjetit duke eliminuar mundësinë e mbushjes se tepërt te alternatorit. Si përfundim grupi i eksperteve shpreh dyshimet se automjeti ka pasur defekte tjera teknike që kanë mundur të ndikojnë ne fillimin e zjarrit e të cilat defekte nuk mund te evidentohen ne gjendjen e tashme te automjetit te djegur.

Përgjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 11.06.2024, përfaqësuesi i grupit të ekspertëve z. N.L., duke iu përgjigjur pyetjeve të gjykatës dhe palëve ndërgjyqëse ka sqaruar edhe më tej se grupi i ekspertëve, për t’i hequr të gjitha dilemat ka kërkuar nga i padituri auto

elektracist “Elmia” që të siguroj një automjet me karakteristika të njëjta për ta vërtetuar si ka ardhur deri tek djegia e automjetit ashtu që gjatë ekzaminimit, kanë krijuar lidhje të shkurtë dhe si rrjedhojë e kësaj lidhje të shkurtë motori i automjetit është fikur, siguresa është djegur. Andaj, është hequr dilema se siguresa e gjetur e djegur gjatë ekzaminimit a është rezultat kur motori ka qenë i ndezur duke lëvizur apo kur automjeti ka qenë i fikur. Ka sqaruar tutje se në raste të tilla të djegies së automjetit duhet të intervenohet para se të filloj procesi i korrozionit, e që në rastin konkret, korrozioni me i madh që e ka kapluar në hapësirën e përparme të kapakut të motorit që lidhet me kabinën, andaj edhe sikur ekspertiza të bëhej me kohë, mundësia që intervenimi në alternator ta ketë shkaktuar këtë zjarr është eliminuar me kohë.

### 3. Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Meqenëse raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2014, për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore gjykata iu referua Ligjit nr. 04/L-77 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje si LMD).

Sipas Nenit 136.1 të LMD-së përcaktohet që “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Referuar dispozitës së lartcekur, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë dhe atë : të ekzistojë shkaktuesi i dëmit, të ekzistojë fakti dëmtues, lidhja shkakore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar dhe kundërligjshmëria e veprimit më të cilin është shkaktuar dëmi.

Në rastin konkret, nga vlerësimi i gjithmbarshëm i provave të administruara, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk ka arritur të vërtetoj me asnjë provë të vetme lidhjen kauzale mes veprimeve të të paditurës me rastin e riparimit të automjetit pronë e paditësit, dhe dëmit të shkaktuar në këtë automjet, si kusht imperativ për mbështetje të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga ekspertiza e hartuar nga grupi i ekspertëve Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike u vërtetua se deri tek djegia e automjetit pronë e paditësit me datë 30.07.2019 nuk ka ardhur si pasojë e riparimit i automjetit nga ana e të paditurës, përmes intervenimit në rregullimin e alternatorit respektivisht ndërrimin e unazës rrëshqitëse të brushave. Poashtu, nga kjo ekspertizë, në mënyrë të qartë u vërtetua se tek automjetet identike sikurse ajo e paditësit, i cili është marrë edhe si mostër nga ana e grupit të ekspertëve, në rastet e krijimit të lidhjes së shkurtë, motori i automjetit automatikisht fiket, kjo në prezencë të

siguresës në automjet, me çka është eliminuar çdo mundësi që djegia e automjetit ka ardhur nga ndonjë lidhje e shkurtë dhe intervenimi që është bërë në alternator. Ekspertizës në fjalë, gjykata ia fali besimin në tërësi, pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale, në mbështetje të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe ka ardhur deri tek konkludimet e qarta të cilat nuk kanë krijuar dyshime sa i përket vërtetimit të faktit se a kanë qenë veprimet e të paditurës shkak i pasojës së shkaktuar në automjetin e paditësit.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, mirëpo gjeti se të njëjtat ishin pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje, pasi që Gjykata erdhi në përfundim se paditëses i mungon baza juridike e kërkesëpadisë dhe nuk është lëshuar në vlerësimin e lartësisë së kompensimit. Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa themeltë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në mbështetje të nenit 450 lidhur me nenin 452 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 892/22, datë 25.06.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.